# K O N T R A T E
## PER THEMELIMIN E SHOQERISE ANONIME ME EMERTIMIN "IMMO - INVEST" SH.A. XHAFZOTAJ DURRES

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKTI TURKU
NOTER
DURRES

1. **PALET**

Ne kuptimin e kesaj kontrate per themelimin e shoqerise anonime me emertimin "IMMO-INVEST" Sh.A.Xhafzotaj Durres,e cila qe ketu e me pas referohet si shoqeri,palet jane :

Zoti Roland Wallaert,i datelindjes 1937,me banim ne 8500 Kortrijk,Dam 10 Belgjike,me pasaporte Nr.562761,me cilesine e drejtorit te shoqerise anonime "IMMO INVEST"Sh.A.Xhafzotaj Durres.

Zoti Fabrice Wallaert,i datelindjes 1967,me banim ne 8500 Kor trijk,Dam 10 Belgjike,me pasaporte Nr.232606,me cilesine e kryetarit te keshillit mbikqyres te shoqerise "IMMO INVEST"

2. **QELLIMI**

Qellimi i kesaj kontrate eshte themelimi i shoqerise anonime " IMMO INVEST"Sh.A. Xhafzotaj Durres,pa oferte publike.

3. Objekti i veprimtasrise se shoqerise percaktohet ne nenin 7 te statutit te shoqerise,i cili i bashkelidhet kesaj kontrate themelimi dhe se bashku me te perbejne dokumentat themelore te shoqerise.

4. **DATA EFEKTIVE**

Kjo kontrate do te jete efektive qe nga data,kur pasi te jet neneshkruar nga ortaket,mbi bazen e saj,te statutit dhe te kerkeses,dhe pasi te jene plotesuar te gjitha kerkesat ligjore,dhe te jete bere regjistrimi i saj ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane,duke u fituar zotesia per te vepruar si person juridik.

5. Kapitali themeltar i shoqerise "IMMO INVEST" Sh.A. eshte

./..

2.000.000 (dymiljon)leke dhe konkretisht merret persiper nga ortaket ne permasat e meposhteme :

Roland Wallaert 1.000.000 leke

Fabrice Wallaert 1.000.000 leke.

SHQIPERISE NOTER DURRES

6. Vlera e mesiperme e kapitalit perbehet nga 200 aksione me vlere 10.000 leke sejcili,te cilat i perkasin sejcilit ortak sipas kapitalit te marre persiper dhe depozituar pre; tyre.Me zgjerimin e kesaj shoqerie kapitali mund te rritet duke u shtuar numri i aksioneve si nga ortaket shtu dhe nga persona te tjere.

7. Ne librin e llogarise te kesaj shoqerie krijohet fondi themeltar i paleve kontraktuese ku shenohen kapitalet e vena nga sejcila pale kontraktuese.

8. Kjo shoqeri do te kete nje kohe zgjatje mbi 10 vjet.

9. Shoqeria "IMMO INVEST" Sh.A. pergjigjet per detyrimet e veta me fondet e saj,si dhe me vlerat e kapitaleve te patu deshme,siç eshte ajo e truallit dhe e ndertimeve te arrira deri me sot dhe me ato qe do te ndertohen ne te ardhmen.

10. Te drejtat e paleve kontraktuese :

- Te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise
- Te marrin pjese ne ndarjen e fitimeve te shoqerise,ne perputhje me statutin.

Palet kontraktuese jane te detyruar :

- Te vene ne kapitalin baze te shoqerise pjesen perkatese statutit dhe nenit 5 te kesaj kontrate themelimi.
- Te veprojne ne inisiative dhe ne interes te realizimit te objektit te shoqerise.

11. Palet kontraktuese rane dakort qe ndarja e fitimeve qe do te rezultoje nga aktiviteti i shoqerise pas likujdimit te taksave dhe detyrimeve te tjera,te ndahet ne mes tyre me nga 50 per qind,sipas perqindjes se aksioneve perkatese.

./..

12. Per te punesuarit ne shoqeri do te zbatohet Kodi i Punes i miratuar me Ligjin Nr.7961,date 12.7.1995.

13. Organizimi dhe drejtimi i shoqerise do te behet nga drejtori i saj zoti Roland Wallaert dhe kryetari i keshillit mbikqyres zoti Fabrice Wallaert.

14. Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim me bisedime ndermjet paleve kontraktuese do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane ose ndonje gjykate e nje rrethi tjeter.

15. Kontrata u perpilua ne pese kopje me te njejten permbajtje.

Durres,me 08.01.1998

O R T A K E T

ROLAND WALLAERT FABRICE WALLAERT

WALLAERT FABRICE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE DURRES

Nr.Rep. 766 Nr.Kol. 341

V E R T E T I M

Sot me daten 25 . 03 .1998,para meje Ali Turku,noter publik ne qytetin e Durresit,u paraqiten personalisht zoterinjte :

1. Roland Wallaert lindur ne Belgjike ne vitin 1937,me banim 8500 Kortrijk,Dam 10,Belgjike.I pajisur me pasaporte Nr.562761,me cilesine e drejtorit te shoqerise "IMMO INVEST" Sh.A. Xhafzotaj Durres.

2. Fabrice Wallaert,lindur ne Belgjike ne vitin 1967,me banim 8500 Kortrijk,Dam 10,Belgjike,me pasaporte Nr.232606,me cilesine kryetarit te keshillit mbikqyres te shoqerise "IMMO INVEST" Sh.A.

Madhore dhe me pergjegjesi te plote per te vepruar,identitetin te cileve e verifikova me ane te pasaportave personale.Te cilet e lexuan kete kontrate dhe e gjeten ne rregull e neneshkruan ate para meje me vullnet te lire.Une noteri vertetoj.

N O T E R I
ALI TURKU